



**REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA**



Komuna e Gjakovës

Dt.06.09.2024

Nr.01/2024

PROCESVERBALI

Nga dëgjimet Buxhetor të organzuara nga Kuvendi i Komunës me Qytetarët e Komunës së Gjakovës, Përfaqësuesit e OJQ-ve të Mbështetur nga OSBE-ja, të mbajtur me dt.06.09.2024 në fillim në ora 13:30 në Sallën Solemne Pallati i Kulturës “ Asim Vokshi”

Të Pranishëm: Kryesuesja e Kuvendit të Komunës znj. Arbënesha Kuqi, Drejtori z. Durim Halilaj, 6 anëtar të Kuvendit dhe të KPF-së, përfaqësues të Zyrës për Informim të OSBE-së , të mediave dhe gjithsejti 3 qytetar.

znj. Arbënesha Kuqi: Të nderuar të pranishëm faleminderit që ju keni përgjigji thirrjes nga Komiteti për Politik dhe Financa të Kuvendit të Komunës së Gjakovës për takimin e radhës në vazhdën e ciklit të dëgjimeve buxhetore i nderuar z. Durim Halilaj, Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa në këtë dëgjim buxhetor të Kuvendit i Komunës për Buxhetin e Komunës së Gjakovës për vitin 2025, për çka e falënderojmë edhe OSBE-në për përkrahjen, deri tani janë mbajtur 9 dëgjime Buxhetore të organizuara nga ekzekutivi i Komunës së Gjakovës konkretisht nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, sipas afateve ligjore para datës 1 Shtator më është dorëzuar Draft Buxheti sipas legjislacionit në fuqi dhe ju kemi shpërndarë anëtarëve të Kuvendit, ne si Kuvend i kemi organizuar dy dëgjime Buxhetore njëri është ky që jemi tani dhe që është shumë numër i vogël i pjesëmarrjes së qytetarëve.

z. Durim Halilaj: Ekzekutivi ka filluar fazën e dëgjimeve buxhetore apo përgatitjen e projekt buxhetit nga muaji Korrik i këtij viti dhe jemi në fazën përfundimtare se si duket një projekt buxhet i komunës së Gjakovës në vitin fiskal 2025.

Me të mare Qarkoren e dytë buxhetore nga Ministria e Financave Drejtoria për Buxhet dhe financa ka organizuar dëgjimet buxhetore dhe njëkohësisht kemi organizuar dhe një qarkore të brendshme në bashkëpunim me Drejtoretë përkatëse për të parë kërkesat e tyre dhe kemi përcaktuar kufijtë që parashihen në këtë projekt buxhet. Projekt buxheti fillestar i Komunës së Gjakovës për vitin fiskal është 40.584.369.00€, që ndahen Tek kategoritë ekonomike siç janë në Paga dhe Mëditje që janë 19,297,938.00€, Mallra dhe Shërbime 4,670,000.00€, Shpenzime Komunale 788,500.00€, Subvencione dhe Transfere 1,085,000.00€ si dhe Investime Kapitale 14,742,931.00€. Draft projekti i Buxhetit të Komunës së Gjakovës i cili është i publikuar janë të ndara të gjitha projektet që planifikohen të investohen në vitin fiskal 2025, sigurisht që këto dëgjime neve si menagjment na bëjnë edhe më përgjegjës për shkak se mund të dalin edhe në kërkesa të caktuara deri në afatin e fundit.

znj. Arbënesha Kuqi: E falënderojmë drejtorin z, Durim Halilaj për këtë prezantim dhe hapi diskutimin për të gjithë të pranishmit për projekt buxhetin e viti 2025.

z. Ali Gojani: Përshëndetje për të gjithë po e ndijë veten shumë të dëshpëruar për këtë numër kaq të vogël të interesimit të pjesëmarrjes së qytetarëve juve ju detyrohet përgjegjësia për të gjetur shkakun e mospjesëmarrjes së qytetarëve unë mendoj që është moskordinimi i punëve me Bashkësítë Lokale sepse probleme kemi mjaft dhe ne jemi ata që duhet ti ndihmojmë. Unë si qytetar kam një kërkesë që në hartimin e buxheti të shtohen mjetet e në Drejtoren e Kulturës dhe

të Arsimit sepse në këto dy sektore është edukimi dhe kultura kombëtare se çfarë nxënës do të edukohen. Ne i përkasim një gjenerate qe kemi punuar me idale e jo me programe politike dhe kushtet kanë qenë shumë më të vështira ndërsa sot kemi shkolla me kushte moderne ndërsa cilësia është shume e dobët gjithashtu edhe kultura është degraduar. Në kulture dhe në arsim duhet të ketë buxhet maksimal dhe njëkohësisht edhe përgjegjësi për shfrytëzimin e atyre fondeve në të kaluarën Gjakova ka qenë shembull për aktivitet kulturore në të gjitha fushat dhe kurora e këtyre aktiviteteve ka qenë Pallati i Kulturës i cili është ndërtuar me vet kontributin e qytetarëve ku për 8 vite të gjithë kanë dhënë 2 % te ardhurave të tyre andaj unë propozoj që të vendoset në tabelë në të cilën do të shënohej se ky pallat është ndërtuar me vet kontributin e qytetarëve. Unë jam anëtar i shoqatës së intelektualëve dhe i kemi propozuar Drejtorisë së Arsimit që ky vit shkollor të shpallet si vit i jepur shqipe.

z. Lulzim Haxhiu: Përvetësuesi për të gjithë jam kryetari i këshillit lokalë numër 1 unë kam qenë pjesëmarrës edhe në dëgjimi buxhetor para disa dite dhe kam shprehur kërkosat e bashkësisë lokale të cilat konsiston kryesisht me ndërtimin e rrugëve në lagjen Rezinë desha të ndalem në listën e projekteve kapitale në pikën 25 e cila thotë ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës tek pika e zezë desha të di më detalisht a i përfshin të gjitha kërkosat ky projekt si dhe pika 7 ndërtimi i rrugës në Rezinë sepse sipas bisedës që kemi pasur kjo pikë përfshin rrugët në pjesën e poshtme në Rezinën Jugore. Kërkoi që në listën e projekteve kapitale të plotësohen emërimet për të qenë më e kuptueshme edhe për ne banorët, shpresoj që këto projekte të përfundojnë në vitin 2025-2026. Kërkosë tjetër e kësaj bashkësinë lokale është ngritja e një lapidari të martirëve te familja Vejsa pasi që në këtë lagje i kemi 60 martirë.










z. Durim Halilaj: Desha të ndalem tek kryetarët e bashkësive lokale dhe desha ti falënderoj që gjithmonë kemi koordinim të mirë së bashku. Sa i përket Kulturës dhe Arsimit keni të drejtë që të ketë edhe përgjegjësi, Drejtoria e Arsimit ka një projekt për rregullimin e kabinetave nëpër të gjitha shkollat e komunës së Gjakovës për ngritjen e cilësisë së arsimit, ndërsa për bashkësia lokale numër 1 janë përfshi rrugët e reja sepse është përfshi harta zonale dhe tek pika e zezë janë përfshi të gjitha rrugët që kanë qenë kërkosë e juaj, tek çerdhja është investim i Ministrisë së Arsimit dhe besoj që këtë vit do të përfundoj ky projekt.

z. Mimoza Shala: Desha të ju falënderoj të gjithëve dhe dola e nxitur nga z. Gojani ku unë personalisht sot mësove qe janë dhënë nga 2% e pagave për ndërtimin e pallatit të kulturës që është shumë motivuese sepse shoqëria sot ka nevojë shumë për shembuj të tillë gjithashtu është e rëndësishme pjesëmarrja e qytetarëve për kërkesa e tyre të qarta sepse pasqyri i kërkosave së arsimit duhet të ju bëjë me dije se sa i përket buxhetit për Kulturë ka dy mandate që ngris zërin për rritjen e buxhetit sepse sinqerisht këtij qyteti i mungon.

z. Arbënesha Kuqi: Meqenëse se nuk ka diskutues të tjerë ju falënderojmë të gjithave për pjesëmarrje dhe OSBE-në për mbështetje dhe mirë u takofshim në takimet tjera.

Lista e nënshkrimeve në dëgjimet buxhetore për buxhetin e viti 2025

Të mbajtur me datë 06.09.2024 me Qytetarët e Komunës së Gjakovës .

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Nënshkrimi
1.	Bajrosh Nikolla-	
2.	Luzim Haxhiu	
3.	Abdullah Zuka Vokshi	
4.	Tecita Pallaska Hilla	
5.	Ermira Mehmeti	
6.	Shpend Bajrami	
7.	Krenare Bushaj	
8.	Ali TATAROFTI	
9.	MHOZA SHAKA	
10.	Fatjona Karochushi	
11.	Suniqje Shllaku	
12.	Arion Haracova	
13.	Ali Gozani	
14.	Hilmi Beli	
15.	Mihmata Bravima	
16.	Besa Zera	
17.	Arbenesh Kuci	
18.		
19.		
20.		
21.		
22.		
23.		
24.		
25.		
26.		
27.		